



3. 4. 2015

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
VLORE

NR. 93 i Rregjistrimit
DT.11.02.2015 i Rregjistrimit

Nr. i vendimit 20
Dt. 17.03.2015 e Vendimit

V E N D I M
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlore, e përbërë nga gjyqtarët:

Margarita Buhali - Kryesuese

Andi Civici - Anëtar

Hysen Saliko - Anëtar

07.04.2015

asistuar nga sekretarja gjyqësore [redacted] më datën 17.03.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr.93 rregjistrimit, me datë rregjistrimi 11.02.2015, që i përket:

KËRKUESE; [redacted] banuese në lagjen [redacted]

Person i tretë; [redacted] banuese në lagjen [redacted] - ne mungese.

2- [redacted] banues në lagjen [redacted] rruga [redacted] - në mungesë.

3- [redacted] banues në lagjen [redacted] rruga [redacted] në mungesë.

4-Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi – në mungesë

5- Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier- ne mungese

Objekti: Korrigjim gabimi në vendim.

BAZA LIGJORE : Neni 312 i K. Pr.Civile.

Në përfundim të gjykimit;

Kërkuesja kërkoi; Pranimin e kërkesës.

Personat e tretë- në mungesë.



RR951190303AL

GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi degjoi relatimin e gjyqtares Margarita Buhali; degjoi kërkuosen që kërkoj pranimin e kërkesës, si dhe shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Gjykata e Apelit Vlorë nëpërmjet kërkesës së kërkuoses [REDAKTUAR] është vënë në dijeni se në vendimin nr. 274/60-2014-2778 dt.09.12.2014 të dhënë nga kjo gjykatë është bërë gabim material për mbiemrin e kërkuoses në pjesën e dispozitivit të vendimit.

Në përputhje me nenet 312 e vijues të K.Pr.Civile kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë është gjykata që ka dhënë vendimin. Sipas vendimit nr. 274/60-2014-2778 dt.09.12.2014 del se ai është dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë. Si rrjedhim kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë është kjo gjykatë dhe i njëjti trup gjykues që ka shqyrtuar ceshtjen.

Kërkuësja pretendoi se ne pjesën e dispozitivit të vendimin 274/60-2014-2778 dt.09.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë është shkruar gabim mbiemri i saj pasi është shënuar « [REDAKTUAR] » kur i sakti është « [REDAKTUAR] ». Me qëllim rregullimin e këtyre gabimeve kërkuësja pretendoi pranimin e kërkesës.

Gjykata pasi shqyrtoi provat e paraqitura, dëgjoi pretendimet e kërkuoses cmon se kërkesa është e bazuar në ligj për këto arsye :

Së pari: Në bazë të nenit 312 të K.Pr.Civile palët kanë të drejtë të kërkojnë në cdo kohë ndreqjen e gabimeve të bëra në shkrim, në llogari ne ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. Në rastin konkret ndreqja e gabimit është e nenit 312 të K.Pr.Civile. Kërkuësja ka qënë palë në vendimin për të cilin pretendohet korrigjimi i gabimit. Kështu që ka interesa të drejtëpërdrejta në gjykim.

Së dyti : Në pjesën e dispozitivit të vendimit nr. 274/60-2014-2778 dt.09.12.2014 të Gjykatës së Apelit është shënuar gabimisht identiteti i kërkuoses « [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ». Sipas pjesës hyrëse të vendimit dhe arsyetimit të tij del e qartë se mbiemri i kërkuoses është « [REDAKTUAR] » Kjo tregon se shënimi i mbiemrit « [REDAKTUAR] » për kërkuosen përbën një gabim në shkrim dhe duhet të korrigjohet në mbiemrin e saktë « [REDAKTUAR] ».

Nga sa më sipër gjykata e gjen kërkesën për ndreqjen e gabimeve, të bazuar në ligj dhe në prova. Shpenzimet sic janë bërë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 306 e 312 e vijues të K.Pr.Civile.

VENDOSI


- Ndrejten e gabimit të bërë në shkrim në dispozitivin e vendimit nr.274/60-2014-2778 dt.09.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlore nga i pasakti « [REDACTED] » në të saktin « [REDACTED] »
- Urdhërohet bashkimi i këtij vendimi, me atë nr.274/60-2014-2778 dt.09.12.2014.
- Shpenzimet gjyqsore sic janë bërë.

U shpall në Vlorë më 17.03.2015

ANETAR
Hysen Saliko



ANETAR
Andi Civici



KRYESUESE
Margarita BUHALI

Margarita Buhali
